8	<p>Furnizimi dhe montimi i Digestorëve Laboratorik (Fume Hood) për Laboratorët e AKF-së:</p> <p>Të jenë te përshtatshëm për përdorim te përgjithshëm dhe multifunksional për laboratorë qe përdorin tretës organik dhe acide &amp; baza te holluara sipas standardit EN: 14175.</p> <p>Kapaciteti optimal i ndotëseve në ajër, i cili ofron fluks të ulët të ndotjes dhe garanton sigurinë në punë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesët metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</li> </ul>	<p>Pyetje 1:</p> <p>Keni kerkuar Digestore Laboratorik me dimensione te jashtme 1800 x 2700 x 900 dhe me hapesire te shfrytezueshme per pune 100 mm me pak se hapesira e jashtme.</p> <p>Sipas prodhuesve me eminent dimensionet standarde te brendshme sipas modeleve jane: 1200 ose 1800 mm. Ndersa ato te jashtme variojne nga 100 deri ne 200 mm me shume se ato te brendshme.</p> <p>-Ju lutemi sqaroni konfirmoni se mund te ofrohet digestor me dimensione te jashtme 1950/2400 mm (2700 mm kur digestori eshte i hapur) x 900 mm dhe me hapesire te shfrytezueshme per pune 1800 x 2700 x 900.</p>	Te ofrohen sipas kerkesës.



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesët jo metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</li> <li>• Ndriçimi i hapësirës se brendshme LED për ndriçim uniform te hapësirës se punës.</li> <li>• Shiriti i dorezës mbajtëse duhet të jetë me sistem të lehtë të funksionimit duke mundësuar hapjen me dorë deri në 500mm</li> <li>• Priza me rregullator (programator) ne hapësirën (dhomën) e digestorit.</li> <li>• Rregullator individual te cilësisë se lartë për gaz, uji dhe rrymë.</li> <li>• Ventilator te integruar.</li> <li>• Funksionet Ergonomike</li> <li>• Me sirtar (Kabinete) te integruar për ruajtjen e Acideve &amp; Bazave dhe te lidhura me sistemin e ventilimit. Dimensionet e jashtme: 1800 x 2700 x 900.</li> <li>• Hapësira e shfrytëzueshme për punë duhet të jetë 100mm me pak se hapësira e jashtme</li> <li>• Vëllimi i rrjedhjes se ajrit: 720 m³/h.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i ujit dhe kanalizimit dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i sistemit te ventilimit dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike (rrymës) dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> </ul>	<p><b>Pyetje 2:</b></p> <p>Keni kerkaur qe pjesët jo metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</p> <p>-Sipas standradeve per digestor laboratorik pjeset jo metalike te siperfaqes se punes mund te jene nga materialet:</p> <p>Keramika monolitike acido rezistente</p> <p>Polypropylene</p> <p>Rreshire epoksi</p> <p>Celik INOX,</p> <p>HPL laminate acido rezistent</p> <p>Melamine multishtresore acido rezistente</p> <p>Gure te perpunuar nga kuarci</p> <p>Kompozite minerale</p> <p>Nga te lartepermendurat siperfaqja e punes me acido rezistente eshte keramika monolitike dhe Polipropileni.</p> <p>Ju lutemi qe te na percaktoni siperfaqen e punes pasi qe cmimet e produkteve me larte ndryshojne shume ne mes vete.</p> <p><b>Pyetje 3:</b></p> <p>Keni kerkuar prizen me rregullator te jete brenda digestorit gje qe nuk rekomandohet per shkak te rrezikshmerise nga avujt kimik.</p>	<p>Te ofrohen sipas kerkesës.</p> <p>Priza me rregullator nënkupton rregullatorin per kontrollimin dhe rregullimin e vëllimit te rrjedhjes se gazrave ne hapsiren e digestorit permes ventilimit dhe mund te jete i vendosur jashte hapsires punuese te digestorit dhe vëllimi i rrjedhjes te jetë i rregullueshëm.</p>
--	--	---

		Ju lutemi konfirmoni se mund te ofrohet digestor me priza jashte digestorit ne pjesen e perparme?	
9	<p>Furnizimi dhe montimi i Digestorëve Laboratorik (Fume Hood) për Laboratorët e AKF-së :</p> <p>Të jenë te përshtatshëm për përdorim te përgjithshëm dhe multifunksional për laboratorë qe përdorin tretës organik dhe acide &amp; baza te holluara sipas standardit EN: 14175.</p> <p>Kapaciteti optimal i ndotëseve në ajër, i cili ofron fluks të ulët të ndotjes dhe garanton sigurinë në punë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesët metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</li> <li>• Pjesët jo metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</li> <li>• Ndriçimi i hapësirës se brendshme LED për ndriçim uniform te hapësirës se punës.</li> <li>• Shiriti i dorezës mbajtëse duhet të jetë me sistem të lehtë të funksionimit duke mundësuar hapjen me dorë deri në 500mm</li> <li>• Priza me rregullator (programator) ne hapësirën (dhomën) e digestorit.</li> <li>• Rregullator individual te cilësisë se lartë për gaz, uji dhe rrymë.</li> <li>• Ventilator te integruar.</li> </ul>	<p><b>Pyetje 1:</b></p> <p>Keni kerkuar Digestore Laboratorik me dimensione te jashtme 1200 x 2700 x 900 dhe me hapësire te shfrytezueshme per pune 100 mm me pak se hapësira e jashtme.</p> <p>Sipas prodhuesve me eminent dimensionet standarde te brendshme sipas modeleve jane: 1200 ose 1800 mm. Ndersa ato te jashtme variojne nga 100 deri ne 200 mm me shume se ato te brendshme.</p> <p>-Ju lutemi sqaroni konfirmoni se mund te ofrohet digestor me dimensione te jashtme 1350/2400 mm (2700 mm kur digestori eshte i hapur) x 900 mm dhe me hapësire te shfrytezueshme per pune 1200 x 2700 x 900.</p> <p><b>Pyetje 2:</b></p> <p>Keni kerkaur qe pjesët jo metalike te digestorit te jenë nga materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryshme.</p> <p>-Sipas standradeve per digestor laboratorik pjeset jo metalike te siperfaqes se punes mund te jene nga materialet:</p> <p>Keramika monolitike acido resistente Polypropylene Rreshire epoksi Celik INOX, HPL laminate acido rezistent</p>	<p>Te ofrohen sipas kerkesës.</p> <p>Te ofrohen sipas kerkesës.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funkzionet Ergonomike</li> <li>• Me sirtar (Kabinete) te integruar për ruajtjen e Acideve &amp; Bazave dhe te lidhura me sistemin e ventilimit. Dimensionet e jashtme: 1200 x 2700 x 900.</li> <li>• Hapësira e shfrytëzueshme për punë duhet të jetë 100mm me pak se hapësira e jashtme</li> <li>• Vëllimi i rrjedhjes se ajrit: 480 m<sup>3</sup>/h.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i ujit dhe kanalizimit dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i sistemit te ventilimit dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> <li>• Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike (rrymës) dhe lidhja përfundimtare me digestorin.</li> </ul>	<p>Melamine multishtresore acido rezistente Gure te perpunuar nga kuarci Kompozite minerale</p> <p>Nga te lartepermendurat siperfaqja e punes me acido rezistente eshte keramika monolitike dhe Polipropileni.</p> <p>Ju lutemi qe te na percaktoni siperfaqen e punes pasi qe cmimet e produkteve me larte ndryshojne shume ne mes vete.</p> <p>Pyetje 3:</p> <p>Keni kerkuar prizen me rregullator te jete brenda digestorit gje qe nuk rekomandohet per shkak te rrezikshmerise nga avujt kimik.</p> <p>Ju lutemi konfirmoni se mund te ofrohet digestor me priza jashte digestorit ne pjesen e perparme?</p>	<p>Priza me rregullator nënkupton rregullatorin per kontrollimin dhe rregullimin e vëllimit te rrjedhjes se gazrave ne hapsiren e digestorit permes ventilimit dhe mund te jete i vendosur jashte hapsires punuese te digestorit dhe vellimi i rrjedhjes te jete i rregullueshem.</p>
--	--	--	---

10	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina laboratorike (për kryerjen e ekspertimeve forenzike) për Laboratorët e AKF-së : Konstruksioni mbajtës metalik (kornizë) me katër këmbë ne formë “A” qe është rezistent ndaj korrozionit, reagensëve dhe kemikateve.</p> <p>Shtresa punuese te jete nga melamina kompakt me presion të lartë, me trashësi 20 mm, e klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine.(Ngjyra përcaktohet nga investitori).</p> <p>Dimensionet: 180 x75 x 75.</p> <p>Secila tavolinë duhet te ketë nga një sirtar (kabinet) për ruajtjen e dëshmive me katër dollap te cilët mbyllen me çelës dhe të jenë te lëvizshëm (me rrota lëvizëse) me mundësi bllokimi, me dimensione: 45 x 600 x (620 ose te ngjashme qe përshtaten me tavolinat, me mbyllje ergonomike.</p>	<p>Keni kerkuar tavolina laboratorike me konstruksioni mbajtës metalik (kornizë) me katër këmbë ne formë “A”.</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet te ofrohet tavolina edhe me konstruksion me kater kembe ne forme “H” ose “C”.</p>	Te ofrohen sipas kerkesës.
11	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina laboratorike (për kryerjen e ekspertimeve forenzike) për Laboratorët e AKF-së : Konstruksioni mbajtës metalik (kornizë) me katër këmbë ne formë “A”, qe është rezistent ndaj korrozionit, reagensëve dhe kemikateve.</p>	<p>Keni kerkuar tavolina laboratorike me konstruksioni mbajtës metalik (kornizë) me katër këmbë ne formë “A”.</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet t e ofrohet tavolina edhe me konstruksion me kater kembe ne forme “H” ose “C”.</p>	Te ofrohen sipas kerkesës.

	<p>Shtresa punuese te jete nga melamina kompakt me presion të lartë, me trashësi <math>20 \pm 1\text{mm}</math>, e klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine</p> <p>Dimensionet: 150 x75 x 75.</p> <p>Secila tavolinë duhet te ketë nga një sirtar (kabinet) kompatibil për ruajtjen e dëshmime me katër dollap te cilët mbyllen me çelës dhe të jenë te lëvizshëm (me rrota lëvizëse) me mundësi bllokimi, me dimensione: 45 x 600 x (620) ose te ngjashme qe përshtaten me tavolinat, me mbyllje ergonomike.</p>		
12	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina laboratorike (për kryerjen e ekspertimeve forenzike):</p> <p>Dimensionet: 150 x 75 x 90 cm</p> <p>Konstruksion metalik (Inox) ne formë "A", rezistent ndaj reagensëve dhe kemikateve, me rrota lëvizëse me mundësi bllokimi.</p> <p>Sipërfaqja: Metalike (Inox ), i lëmuar, rezistent ndaj reagensëve dhe kemikateve.</p>	<p>Keni kerkuar tavolina laboratorike me konstruksioni mbajtës metalik (kornizë) me katër këmbë ne formë "A".</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet t e ofrohet tavolina edhe me konstruksion me kater kembe ne forme "H" ose "C".</p> <p>-Ju lutemi na sqaroni se a behet fjale per karroce pasiqe dimensioned jane si per karroce?</p>	<p>Te ofrohen sipas kërkesës.</p> <p>Tavolinë pune lëvizese</p>
13	<p>Furnizimi dhe montimi me Kabinet metalik me rrota (lëvizëse)</p>	<p>-Ju lutemi na jepni me shume informata per kete pozicion, p.sh sa sirtare, dyer dhe rafte duhet te kene</p>	

	Për ruajtjen e veglave dhe reagjentëve ne Laboratorin e Balistikes me shumë fioka/dollapë. (Për restaurimin kimik e NIA). Dimensionet: 100 x 60 x 120	per shkak se keto elemente e percaktojne edhe cmimin?	Kabineti duhet ti kete 4 fioka/dollapë me shirit levizës per hapje dhe mbyllje.
14	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina Laboratorike te dyfishtë (te kombinuara ne formë te ishullit):</p> <p>Të posedoj dy lavaman ne pjesën ballore, një dush për pastrim emergjent te syve dhe pajisjet përcjellëse për kanalizim dhe furnizim me uji, për pjesën e Labororit te Daktiloskopisë.</p> <p>Dimensionet 360x200x 90 me një raft për vendosje te kemikateve ne mes për qasje nga te dy anët dhe me kabinete përcjellëse qe mbyllen me çelës. Materiali i pjesës se sipërme për pune te jete nga melamina kompakt me presion të lartë me trashësi 20 mm, i klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine</p>	<p>-Ju lutemi na jepni informata me shume per lavamanet per dimensionet e peraferta dhe materiali i lavamanit si p.sh Polipropilen.</p> <p>A duhet te jene per uje te ftohet dhe te ngroht apo vetem nje rubinete?</p> <p>Gjithashtu ju lutemi na informoni se a duhet te jene kabinetet fikse ne tavoline apo levizese?</p> <p>Poashtu Dimensionet e dhena 360x200x 90 po supozojme se duhet te jene centimetra?</p>	<p>Dimensionet e lavamanit duhet te jenë: 380 x 380 mm 250 mm thellësi, materiali te jetë Inox.</p> <p>Me mundesi per uji te ftohtë dhe te ngrohtë</p> <p>Kabinetet duhet te jenë levizese</p> <p>Dimensionet duhet te jenë ne cm.</p>
15	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina Laboratorike te dyfishtë (te kombinuara ne formë te ishullit) për Laboratorin e Balistikes:</p> <p>Dimensionet: 300x150x90 cm.</p> <p>Konstruksioni mbajtës metalik qe është rezistent ndaj korrozionit, reagensëve dhe kemikateve, Shtresa punuese te</p>	<p>-Ju lutemi na jepni me shume informata per kete pozicion:</p> <p>-Cili eshte konfigurimi i kabineteve dere apo sirtare?</p> <p>-Sa dyer apo sirtare duhet ti kene?</p>	<p>Sirtarë</p> <p>Kabineti duhet ti ketë 4 sirtarë</p> <p>Secila Tavolinë duhet ta ketë nga nje kabinet percjellës.</p>

	<p>jete nga melamina kompakt me presion të lartë, me trashësi 20 mm, e klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine, me mundësi për qasje nga te dy anët dhe me kabinete përcjellëse qe mbyllen me çelës.</p>	<p>- Sa eshte numri i kabineteve percjellese qe duhet ofruar?</p> <p>-A duhet te jene kabinetet fikse ne tavoline apo levizese?</p> <p>-Nese duhet te jene fikse a duhet te kete hapesire pergjate tavolines pa kabinet per nevojte te uljes ne karrige te personelit?</p>	<p>Kabinetet duhet te jenë levizese.</p>
16	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina Laboratorike te dyfishtë (te kombinuara ne formë te ishullit) për Laboratorin e Daktiloskopisë:</p> <p>Te jenë të përshtatshme për tu vendosur afër murit, me shtrese uniforme ose parciale, qe izolohet ne kontakt me murin.</p> <p>Dimensionet: 750x60x75 cm.</p> <p>Konstruksioni metalik ne formë “C” rezistent ndaj reagensëve dhe kemikateve.</p> <p>Materiali i pjesës se sipërme për pune te jete nga melamina kompakt me presion të lartë me trashësi 20 mm, i klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine, dhe me kabinete përcjellëse me rrota lëvizëse, qe mbyllen me çelës.</p>	<p>-Ju lutemi na jepni me shume informata per kete pozicion:</p> <p>-Cili eshte konfigurimi i kabineteve dere apo sirtare?</p> <p>-Sa dyer apo sirtare duhet ti kene?</p> <p>- Sa eshte numri i kabineteve percjellese qe duhet ofruar?</p>	<p>Sirtarë</p> <p>Kabineti duhet ti ketë 4 sirtarë</p> <p>Secila Tavolinë duhet ta ketë nga nje cabinet percjelles.</p>



16	<p>Furnizimi dhe montimi me tavolina laboratorike me kabinetet përcjellëse (për kryerjen e ekspertimeve forenzike) për Laboratorin e Daktiloskopisë.</p> <p>Te jenë të përshtatshme për tu vendosur afër murit, me shtrese uniforme ose parciale, që izohet në kontakt me murin.</p> <p>Dimensionet: 750x60x75 cm.</p> <p>Konstruksioni metalik në formë “C” rezistent ndaj reagensëve dhe kemikateve.</p> <p>Materiali i pjesës së sipërme për punë të jete nga melamina kompakt me presion të lartë me trashësi 20 mm, i klasës (cilësisë) Laboratorike me skaje harkore me shtresë melamine, dhe me kabinete përcjellëse me rrota lëvizëse, që mbyllen me çelës.</p>	<p>-Ju lutemi na jepni me shumë informata për këtë pozicion:</p> <p>-Cili është konfigurimi i kabinetëve derë apo sirtarë?</p> <p>-Sa dyer apo sirtarë duhet të kenë?</p> <p>- Sa është numri i kabinetëve përcjellës që duhet ofruar?</p>	<p>Sirtarë</p> <p>Kabineti duhet të ketë 4 sirtarë</p> <p>Secila Tavolinë duhet të ketë nga një kabinet përcjellës.</p>
----	---	--	---

17	<p>Furnizimi dhe montimi me karrige laboratorike për Laboratorët e AKF-së:</p> <p>KLIMASTAR PUR shkumë integrale rezistente ndaj reagensëve dhe kemikateve.</p> <p>Karriget te jenë ortopedike dhe te përshtatshme për qëndrim të gjatë.</p> <p>Karrige e kthyeshme WS 9220 gri e lehte ose e zezë (RAL 7035) PUR mbështetëse integrale dhe ulëse të shkumës Tub i mbuluar me krom. Këmbët nga Inoksi me rrota me mundësi frenimi, me mbështetëse te këmbëve po ashtu rezistente ndaj reagensëve dhe kemikateve.</p>	<p>Pyetje: Keni kerkuar Furnizimi dhe montimi me karrige laboratorike për Laboratorët e AKF-së.</p> <p>-Keni cekur modelin KLIMASTAR PUR WS 9220 nga nje prodhues I caktuar dhe kjo kerkese eshte diskriminuese.</p> <p>-Ju lutemi te lejohet te ofrohet karrige laboratorike edhe nga prodhues tjere me specifika si me poshte:</p> <p>Karrige rrotulluese me rregullim te larte per laborator. Ulesja dhe pjesa e pasme e rehatshme, jo rreshqitese, nga poliuretani i bute me ngjyre te zeze. Lartesia e rregullushme me mbeshtetese kembesh te kromuar. Baza eshte bere nga poliamidi duke perfshire perberjen e tekstil me fije qelqi. Liferohen me rrota.</p> <p>Materiali i uleses / mbeshteteses: Poliuretani qe nuk rreshqet, pastrohet lehte, rezistent ndaj detergjenteve gerryes dhe pastrues.</p> <p>Sipas standardeve kemi dy lloje te karrigave: te uleta dhe te larta.</p> <p>Karrigat e uleta jne per pune ne tavolinave te lartesisë 75 cm dhe karrige e larte per pune ne tavoline me lartesi 90 cm.</p> <p>Ju lutemi konfirmoni se a duhet ofruar karrige te uleta apo karrige te larta?</p>	<p>Te ofrohen sipas kërkesës apo ekuivalente.</p>
----	--	--	---

18	<p>Furnizimi dhe montimi me kabinete për ruajtje të kimikateve për Laboratorët e AKF-së :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Që mbyllet me çelës për të siguruar qasjen e pa autorizuar.</li> <li>• Duhet të lidhjet me sistemin e nxjerrjes së gazrave dhe ventilimit.</li> <li>• Material: Metal i shkallës së lartë (1.0330), i elektro galvanizuar dhe i mbuluar me shtresë polyuretani apo i ngjashëm</li> <li>• Dyert: Dy dyer të papërshkueshme nga zëri me dy shtresa.</li> <li>• Dorezat e dyerve: Zinku të kompresuar, i lyer me shtresë Kromi apo i ngjashëm.</li> <li>• Dimensionet: 120x60x200</li> <li>• Raftet të lëvizshme: me kapacitet – 30 kg, vëllim-12 l.</li> <li>• Ventilator të integruar për ventilim aktiv.</li> <li>• Raftet të lëvizshme me mundësi ergonomike për shtyrje/tërheqje apo të ngjashme.</li> </ul>	<p>Pyetje: Keni kërkuar Furnizimi dhe montimi me kabinete për ruajtje të kimikateve me dy dyer të papërshkueshme nga zëri me dy shtresa.</p> <p>-Ju lutem që të sqaroni se a keni menduar që dyert të jenë të</p> <p>-Ju lutemi që të pranohet kabinet me dimensione External dimensions: mm 120 x 50 x 199 h nga ato të kërkuara 120x60x200.</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se pranohet kabinet me raftet fikse me kapacitet deri në 100 kg, vëllim deri në 15 L pasi që rafti fiks ka me shumë siguri për ndonjë aksident gjatë levizjes së raftit levizës</p>	Te ofrohen sipas kërkesës
----	---	--	---------------------------

19	<p>Furnizimi dhe montimi me kabinet për Baza &amp; Acide për Laboratorët e AKF-së :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për ruajtjen e kemikateve korrozive (Acide&amp;Baza) jo te ndezshme.</li> <li>• Duhet te lidhet me sistemin e nxjerrjes se gazrave dhe ventilimit për ti larguar gazrat agresive.</li> <li>• Kabinetet duhet te jene te ndërtuara nga materiali i fortë/plotë polypropilen rezistent ne Acide&amp;Baza</li> <li>• Dyert/Dorëzat e dyerve: Zinku te kompresuar, i lyster me shtresë Kromi apo i ngjashëm.</li> <li>• Raftet: Te ndërtuar nga polypropyleni i fortë/ngurtë, i padepërtueshëm për likuide.</li> <li>• Çelësi: Kabinetet duhet te mbyllen me çelës/bravë rezistente ndaj korrozionit</li> <li>• Dimensionet: 60x60x200</li> <li>• Raftet te lëvizshme: me kapacitet – 30 kg, vëllim-12 l.</li> <li>• Ventilator te integruar për ventilim aktiv te avujve (gazrave) agresive.</li> <li>• Raftet lëvizëse me mundësi ergonomike për shtyrje/tërheqje apo te ngjashme.</li> </ul>	<p>Pyetje: Keni kerkuar Furnizimi dhe montimi me kabinate për Baza &amp; Acide te jene te ndërtuara nga materiali i fortë/plotë polypropilen rezistent ne Acide&amp;Baza</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet te ofrohet kabinet i prodhuar teresisht nga çeliku i elektrogalvanizuar, i lyster me pluhur epoksi acido rezistent?</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet te ofrohet kabinet me raftet te nga çeliku dhe elektrogalvanizuar, i lyster me pluhur epoksi acido rezistent?</p> <p>-Ju lutemi qe te pranohet kabinet me dimensione External dimensions: mm 60 x 50 x 199 h nga ato te kerkuara 60x60x200.</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se pranohet kabinet me raftet fikse me kapacitet deri 40/100 kg, vëllim 8 L, pasi qe rafti fiks ka me shume siguri per ndonje aksident gjate levizjes se raftit levizes?</p>	Te ofrohen sipas kerkeses
20	<p>Furnizimi dhe montimi me kabinate për ruajtjen e tretësve te ndezshëm për siguri kundër zjarrit për Laboratorët e AKF-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për ruajtjen e tretësve te ndezshëm.</li> <li>• Te testuar për rezistencë ndaj zjarrit (tipi 90) sipas standardit EN 14470-1</li> </ul>	<p>Pyetje: Keni kerkuar Furnizimi dhe montimi me kabinate për ruajtjen e tretësve te ndezshëm për siguri kundër zjarrit me panelet e jashtme metalike te mbuluara me shtresë polyuretani</p> <p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet te ofrohet kabinet i prodhuar teresisht nga çeliku i elektrogalvanizuar, i lyster me pluhur epoksi acido rezistent?</p>	Te ofrohen sipas kerkeses

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dyert: Mbyllja automatike termo mekanike ne rast te zjarrit</li> <li>• Duhet te ketë lidhje te integruar me sistemin e nxjerrjes se gazrave dhe ventilimit për ti larguar gazrat agresive.</li> <li>• Materiali: Dyert dhe skeleti duhet te jene me mure te dyfishta dhe te izoluara (rezistente) ndaj temperaturave te larta (nxehhtësisë) Panelet e jashtme metalike te mbuluara me shtresë polyuretani.</li> <li>• Certifikatat: Duhet te ketë e certifikatën e testit kundër zjarrit EN 14470-1, Tip 90 (90 minuta rezistente ndaj zjarrit)</li> <li>• Lidhjet: lidhjet e dyerve duhet te kenë shirita izolues te ndjeshëm ndaj nxehhtësisë te cilët ënjten (fryhen) ne rast te zjarrit.</li> <li>• Çelësi: Çelësi i sigurisë me tregues vizual për gjendjen e çelësit.</li> <li>• 4 rafte te lëvizshme sirtar me mundësi te tërheqjes ose shtyrjes, me kapacitet – 75 kg, ose vëllim 75 l. ose te ngjashme (vetë tërheqës/mbyllës ne rast zjarri)</li> <li>• Kabinetet duhet te kenë mundësin ergonomike për shtyrje/tërheqje te dyerve apo te ngjashme.</li> <li>• Dimensionet: 60x60x200</li> </ul>	<p>-Ju lutemi konfirmoni se lejohet te ofrohet kabinet me kapacitet 80 kg me vëllim te brendshem deri ne 408 L?</p> <p>-Ju lutemi qe te pranohet kabinet me dimensione External dimensions: mm 68 x 65 x 198 h nga ato te kerkuara 60x60x200.</p>	
	Furnizimi dhe montimi me UPS për pajisje:	<p>-Ju lutemi qe te pranohet UPS me peshe me ndryshe nga ajo e kerkuar 62 kg si p.sh 50 deri 65 kg pasi qe kjo</p>	Te ofrohen sipas kerkeses apo ekuivalente.

21	<p>Fuqia 5000 VA</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Tensioni 220 / 230 / 240 V</li><li>• Tolerance e tensionit 230 V ±20%</li><li>• Frekuenca 50 / 60 Hz ±5</li><li>• Pesha 62 kg</li><li>• Dimensionet 250*698*500 mm</li><li>• Bateria 4-6h</li><li>• Koha 8 min</li></ul>	<p>specifike nuk ndikon ne performance te UPS-it dhe eshte diskriminuese si kriter.</p> <p>-Ju lutemi qe te pranohet UPS me dimensione me ndryshe nga ajo e kerkuar 250*698*500 mm pasiqe kjo specifike nuk ndikon ne performance te UPS-it dhe eshte diskriminuese si kriter.</p> <p>-Ju lutemi na sqaroni se cka nenkuptohet me Bateria 4-6h?</p> <p>-A eshte menduar ne bateri qe duhet te mbaje autonomi ne mungese rryme 4-6 ore? Nese duhet te ofrohet autonomi prej 4 – 6 ore UPS-si i tille duhet te kete nje numer shume me te madh te baterive.</p> <p>-Ju lutemi sqaroni se cka eshte menduar ne kohen prej 8 min? A eshte menduar qe UPS-i te jep rryme per 8 min ne mungese te energjise elektrike?</p> <p>-Ju lutemi sqaroni se sa duhet te kete autonomi UPS-i ne mungese te energjise elektrike?</p>	
22	<p><b>Pyetje I:</b></p> <p><b>Keni kërkuar Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë së paku 3 punëtor te certifikuar për instalim te digësorëve nga prodhuesi.</b></p>		<p>Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punetor te certifikuar nga prodhuesi per instalim te digestoreve.</p>

	<p>Ju lutemi qe AK te pranoje edhe një kontrate ne mes te Operatorit Ekonomik dhe prodhuesit duke cekur numrin e prokurimit te kësaj dosje e te tenderit dhe te bashkëngjitet certifikatat e personelit te certifikuar si pjesa e stafit te prodhuesit qe eshte ne interes edhe te AK qe vet prodhuesi te dërgoj ekipin e certifikuar i cili ka vetëm këtë veprimtari?</p>	<p>Dëshmi: OE duhet te ofroj listen e punetoreve me certifikata dhe kontrtat ose marrëveshjet e punës per kete projekt.</p>
23	<p><b>Pyetje 2:</b></p> <p>Keni kërkuar Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë se paku 3 punëtor te certifikuar për instalim te digësorëve nga prodhuesi.</p> <p>Ju lutemi qe AK te pran oje edhe një kontrate ne mes te Operatorit Ekonomik dhe prodhuesit duke cekur numrin e prokurimit te kësaj dosje te tenderit dhe te bashkëngjitet certifikatat e personelit le certifikuar si pjese e stafit te prodhuesit pasi qe është ne interes edhe te AK qe vet prodhuesite dërgoj ekipi te certifikuar i cili ka vetëm këtë veprimtari?</p>	<p>Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punetor te certifikuar nga prodhuesi per instalim te digësoreve.</p> <p>Dëshmi: OE duhet te ofroj listen e punetoreve me certifikata dhe kontrtat ose marrëveshjet e punës per kete projekt.</p>
24	<p><b>Pyetje 3:</b></p> <p>Ju lutemi qe te pranoni dimensionet me devijim +5% nga ato te kërkuara me specifika te Aneks 1.</p>	<p>Te ofrohen sipas kërkeses</p>
25	<p><b>Pyetje 4:</b></p> <p>Për Art. 1 Keni kërkuar se Artikujt 1 dhe 2 duhet tej e11e te certifikuar me standardet EN 14175-1 EN 14175-2 EN 14175-3 EN 14175-6 EN 14175-7</p> <p>Duke pasur protokollet nderkomtare te akreditimit dhe standardizimit te precizuara ne mënyre strikte ne lidhje me standardin EN 14175, ju nuk keni përshkruar aplikimet për temperaturën te larta ne një pun ditore, brenda specifikimeve por behet fjalë për acide dhe bazë te holluar prandaj kërkojmë qe te largohet kërkesa për standardin EN 141 75-7</p> <p>Ju lutemi konfirmoni se kërkesa juaj do te thotë saktësisht se është e nevojshme dhe e mjaftueshme te paraqesim Certifikatën e përputhshmërisë SIPAS EN 14175-2, dhe raportet e testimit ne përputhje me EN 14175-3; dhe EN 14175-6.</p> <p>Certifikatat për raportet e testimit te lëshuara nga nje laborator Testimi i pa varura, i akredituar ne bazë te 17025 EN 14175) .</p>	<p><b>Hiqet standardi</b> EN 14175-6 dhe EN 14175-7 te tjerat te ofrohen sipas kërkeses</p>

	<p>Keni kërkuar qe paisjet Jo metalike te dikasterit te jene materiali rezistent ndaj korrozionit, acideve &amp; bazave dhe avujve te kemikateve te ndryeshem.</p> <p>-Ju lutemi qe te specifikoni se çfarë materiali duhet te jene pjesët jo metalike pasi lloji i materialit përcakton edhe çmimin.</p> <p>-A do te thoni se mbrojtja e duhur kundër korrozionit duhet ti vërtetohet me certifikata ose raporte testimi për fletat e mbuluara me një shtrese poliesteri, te cilat vlerësohen ne testim e rezistencë ndaj korrozionit sipas ISO 9227: 2017;</p> <p>a) shkalla e fryrjes sipas PN-EN ISO 4628-2: 2016-03 eshte 0</p> <p>b) &lt; dhe shkalla e korrozionit sipërfaqësore sipas PN-EN ISO 4628-3: 2016-03 eshte RiO.</p>	
26	<p><b>Pyetje 5:</b></p> <p>Për Artikullin 1 keni kërkuar Vëllimi rrjedhjes se ajrit: 720 m<sup>3</sup>/h dhe për Artikullin 2 Vëllimi i rrjedhjes se ajrit: 480 m<sup>3</sup>/h.</p> <p>A do te thotë qe fluksi i ajrit duhet te jete MINIMAL 720, pra 480 m<sup>3</sup>/h, duke patur parasysh qe kërkesa ne specifika nuk kërkon sistemet VAV ( Variable Air Volume) por rrjedhje fikse dhe me këtë rast ju lutem qe te largoni kërkesën për standardin EN 14175-6</p>	<p>Priza me rregullator nënkupton rregullatorin per kontrollimin dhe rregullimin e vëllimit te rrjedhjes se gazrave ne hapsiren e digestorit permes ventilimit dhe mund te jete i vendosur jashte hapsires punuese te digestorit dhe vëllimi i rrjedhjes te jete i rregullueshem.</p> <p>Kapaciteti maksimal i vëllimit te rrjedhjes 720 m<sup>3</sup>/h rrespektivisht 480m<sup>3</sup>/h.</p>
27	<p><b>Pyetje 6:</b></p> <p>Për Artikullin 12 Furnizimi dhe montimi me kabinete për ruajtje te kimikateve për Laboratorët keni kërkuar: Dyer: Dy dyer te pa përshkueshme nga zëri me dy shtresa.</p> <p>Duke pasur parasysh se është një kabinet magazinimi kimik, ju lutemi qe ta largoni këtë kërkesë pasi qe nuk ka te bej me kimikatet dhe as sigurimin njerzore ne lidhje me kimikatet, qfar do qoftë.</p>	<p>Te ofrohen sipas kerkeses</p>



**Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë.**


**Afati i dorëzimit të furnizimeve\ montimit duhet të jetë jo më shumë se 60 ditë kalendarike, nga marrja e Fletë porosisë nga Menaxheri i Kontratës.**

**Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

		<b>Datë:</b>	<b>14.11.2022</b>
<b>PËR:</b>	Tenderuesi ankues Të gjithë palët e interesuara		
<b>NGA:</b>	Agim ISLAMI  Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit - MPB		
<b>TEMA:</b>	Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"		

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 11.11.2022, nga një tenderues ka pranuar kërkesë për rishqyrtim, për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF" me nr. të prokurimit 214-22-10141-1-1-1 dhe nr. të e-prokurimit 214-22-102-111. Në pajtim me nenin 108/A të të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 14.11.2022 mori këtë:


**V E N D I M**  
**MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT**

- I. Pezullohet aktiviteti i prokurimit për tenderin Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF" me nr. të prokurimit 214-22-10141-1-1-1 dhe nr. të e-prokurimit 214-22-102-111
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	15.11.2022
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Operatorin Ekonomik, N.T.P "ERAMED, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	e-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Agim ISLAMI,  Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit - MPB
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftime për Kërkesën për Rishqyrtim, për Aktivitetin e prokurimit, "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, kundër Njoftimit për kontratë të datës 05.10.2022 në platformën elektronike, hapja e ofertave e planifikuar te behet me dt. 16.11.2022 ne ora 13:30.


Ne 11.11.2022 ne ora 15:50 është derguar Kerkese per Rishqyrtim para hapjes se tenderit e cila është planifikuar te hapën me 16.11.2022.

Autoriteti Kontraktues duke u bazuar ne nenin 60.1 pika a te Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, citat: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0), mbi bazen e kësaj AK-MPB nuk e ka trajtuar këtë kërkesën për shkak se kërkesa per rishqyrtim është e jashtë afatshme.*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

<b>DATË/A:</b>	15.11.2022
<b>REFERENCE:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Te gjitha palet e interesuara
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	e-prokurimit
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Agim ISLAMI,  Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit - MPB
<b>TE MA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Njoftime

Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, ju njoftojmë se AK-MPB vazhdon me tutje me këte aktivitet të prokurimit dhe pranimi dhe hapja e ofertave të bëhet me dt. 16.11.2022 në ora 13:30.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

*Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement*

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES<sup>1</sup>**

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF"**

Nr. i prokurimit		214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm		214-22-102-111
Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave €
1	EGO ELSA SH.P.K., Rr.Mehmet Gradica nr.26, Bregu i Diellit, 10000, Prishtine,Kosove	375,735.00
2	Vitech Sh.p.k., Rr. Vicianum nr. 210, 10000, PRISHTINË	379,500.04
3	Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	268,450.00
4	Interlab SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	382,999.81

**Rezultati i aktivitetit të prokurimit:**

**Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë tenderuesin: " EGO ELSA SH.P.K", në vlerë totale të ofertës në shumë prej 375,735.00 €.**

Data: 09/12/2022

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

<sup>1</sup> Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>2</sup>

Prishtinë: 09.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Vitech Sh.p.k"

Nr. i prokurimit <sup>3</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digestoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtorëve me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju nuk keni prezantuar fare dëshmi listën e punëtorëve siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

<sup>2</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

<sup>3</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

2. Te kërkesa: Artikujt 1 dhe 2 te duhet te jene te certifikuar me standardët EN 14175-1 EN 14175-2 EN 14175-3

Dëshmi:

Kopja e certifikatave te EN Standardeve.

Për këtë kërkesë ju nuk keni prezantuar fare dëshmi siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.( Kopjet e certifikatave te EN Standardeve)

3.Te kërkesa: Operatoret ekonomik, duhet të sjellin katalogët për artikujt 1 dhe 2.

Dëshmi:

Katalogët duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe te jen ne përputhje me kërkesat ne Aneksin I te dosjes se tenderit.

Për këtë kërkesë ju nuk ka prezantuar fare dëshmi (katalogun) me specifikim teknik siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_,  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]



## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>4</sup>

Prishtinë: 09.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Flamur Isufi B.I.,"

Nr. i prokurimit <sup>5</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1.Tenderi juaj është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar sepse katalogu i dorëzuar me specifikim teknik nuk i përmbush kërkesën minimale të specifikimeve teknike siç është kërkuar me dosjen e tenderit dhe në sqarime të datës 04.11.2022 , pasi që ka mos përputhje ndërmjet dimensioneve të kërkuara dhe dimensionet që keni ofruar në katalog: për artikullin 1 është kërkuar që gjatësia të jetë 2700 mm ndërsa është ofruar sipas katalogut 2400 mm dhe për artikullin 2 është e njëjta është kërkuar 2700 mm ndërsa është ofruar sipas katalogut tuaj 2400 mm dhe të pjesa e vëllimi i rrjedhjes së ajrit për artikullin është kërkuar të jetë : 720 m³/h dhe artikulli 2 Vëllimi i rrjedhjes së ajrit duhet të jetë 480 m³/h për këtë kërkesë në katalogun tuaj nuk ka fare dëshmi lidhur me vëllimin e rrjedhjes së ajrit.

<sup>4</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

<sup>5</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.



Andaj katalogu nuk i përmbush kërkesat minimale siç janë kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

2. Te kërkesa Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digëstoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtove me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju keni prezantuar listën e punëtove te certifikuar nga prodhuesi por nuk keni prezantuar kontratat ose marrëveshje për dy punëtoret me initiale, Z. I. dhe G. R. , siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta tij është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_,  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]

## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>6</sup>

Prishtinë: 09.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Interlab SH.P.K.,"

Nr. i prokurimit <sup>7</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF  
I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digestoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtorëve me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju keni prezantuar një liste te punëtorëve nga prodhuesi ku shkruan qe këta punëtor janë te certifikuar por nuk keni ofruar fare dëshmi për certifikatat dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt siç janë kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

<sup>6</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

<sup>7</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

2. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor financiar i OE i realizuar në tri vitet e shkuara 2019-2020-2021 kanë qenë jo me pak se 600,000.00 €.

Dëshmi:

Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës (kopje).

Te kjo kërkesë ju keni dëshmuar qarkullim përmes një deklarate bankare për 3 vitet por qe nuk e plotëson kërkesën siç është kërkuar ne dosje te tenderit, pasi qe ju eliminoi për arsyeje tjera komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar dëshmi bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara nga Administrata Tatimore.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta tij është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_,  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]



## B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

Prishtinë: 09.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

**MPB– Departamenti i Prokurimit**

**Adresa:** Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

**Adresa e tenderuesit: " EGO ELSA SH.P.K "**

Nr. i prokurimit <sup>8</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

**Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF**

I/e nderuar(a) [Z/ Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ne vlerë prej:375,735.00 €*, si përgjigje ndaj *njoftimit të kontratës* për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]

<sup>8</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

		Datë:	14.12.2022
PËR:	Tenderuesi ankues Të gjithë palët e interesuara		
NGA:	Agim ISLAMI <i>[Signature]</i> Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit - MPB		
TEMA:	Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit për aktivitetin e prokurimit: " Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF "		

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 13.12.2022, nga një tenderues ka pranuar kërkesë për rishqyrtim, për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF" me nr. të prokurimit 214-22-10141-1-1-1 dhe nr. të e-prokurimit 214-22-102-111. Në pajtim me nenin 108/A të të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 14.12.2022 mori këtë:

**V E N D I M**  
**MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT**

- I. Pezullohet aktiviteti i prokurimit për tenderin Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF" me nr. të prokurimit 214-22-10141-1-1-1 dhe nr. të e-prokurimit 214-22-102-111.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATE/A:	16.12.2022
REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Interlab SH.P.K.,
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	e-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Agim Islami Zv. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit- MPB
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtimi për Aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesë për Rishqyrtimi të Tenderuesi "Interlab SH.P.K., të datës 13/12/2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09/12/2022 në platformën elektronike, AK, mbështetur në Ligjit nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e tenderuesit "Interlab SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09/12/2022.

Autoriteti Kontraktues – MPB-ja, për këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të hapur, ka publikuar Njoftimin për kontratë, në sistemin elektronik e-prokurimi të KRPP-së me datën 05/10/2022, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte 16.11.2022.

Pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09/12/2022 kemi pranuar Kërkesë për Rishqyrtim nga tenderuesi "Interlab SH.P.K.

### PRETENDIMET ANKIMORE

Tenderuesi "Interlab SH.P.K.-, si pale e pakënaqur ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK me datën 13/12/2022, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09/12/2022, për tenderin, "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111 , duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068, siç janë:

Dispozitat e shkelura të Ligjit të Prokurimit Publik sipas Interlab SH.P.K, është si vijon:



### DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Kerkese per rishqyrtim paraqitet kunder njoftimit mbi vendimin AK-se te dates:09.12.2022 pasi qe ka rekomanduar per dhenie te kontrates OE EGO ELSA SH.P.K, sepse nuk i ploteson kerkesat e perzgjedhjes apo kualifikimit pasi kete e kemi konstatuar pas qasjes ne dokumentacionin e ofertes.

#### **OE EGO ELSA SH.P.K I PAPËRGJEGJSHEM**

Pas qasjes ne oferte te operatorit ekonomik Ego Elsa sh.p.k, kemi konstatuar se mungon autorizimi nga prodhuesi siq ka qene kerkese obligative te kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale te dosjes se tenderit. Pra mungon autorizimi nga prodhuesi me seli ne Itali siq e ka cekur te lista e përshkrimit te cmimeve te pozicioni "Furnizimi dhe montimi me UPS për pajisje". Për me shume shif dokumentin ne fjalë:

LIVRESHIRJE: DUKOMIZU						
Furnizimi dhe montimi me UPS për pajisje:						
15	<ul style="list-style-type: none"><li>• Fuqia 5000 VA</li><li>• Tensionit 220 / 230 / 240 V</li><li>• Tolerancë e tensionit 230 V ±20%</li><li>• Frekuenca 50 / 60 Hz ±3</li><li>• Pesha 62 kg</li><li>• Dimensionet 250*698*500 mm</li><li>• Bateria 4-6h</li><li>• Koha 8 min</li></ul>					Itali
	Copë	15	1800.00	27000.00		
Gjithsej :				375735.00	375735.00	

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i OE:	EGO ELSA SHPK
Emri dhe mblemri i perfaqesuesit te OE:	EGON HOTI
Nenshkrimi:	
Data:	13.12.2022
Vula:	



Autoriteti kontraktues është dashur të kualifikoj operatorin ekonomik si të përgjegjshëm për shkak se mungon autorizimi nga prodhuesi me seli në Itali për pozicionin numer 15 të listës së përshkrimit të çmimeve me titull *"Furnizimi dhe montimi me UPS për pajisje"*, por ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Poashtu në si OE pjesëmarrës në këto aktivitete të prokurimit publik, pasice jemi në kontakt me prodhuesin e njëjtë Wesemann të ofruar poashtu nga OE EGO - ELSA si OE i rekomanduar për kontratë, gjatë komunikimeve paraprake me prodhuesin në fjalë jemi njoftuar zyrtarisht se për pozicionet nr 6 dhe 12 nuk mund të ofrohen produkte të prodhuara nga ky prodhues. Dhe në si OE për pozicionet 6 dhe 12 kemi ofruar produkte nga prodhues



Angebot WIAN22035104		15/16			
Pos.	Text	Amount	Unit	Price	Total Price in €
	1 x bottom collecting sump (sheet steel powder-coated)				
	<b>Summe: Laboratory furniture</b>				<b>286.932,72</b>
	<b>Summary:</b>				
1	<b>Laboratory furniture</b>				<b>286.932,72</b>
1.1	fume hood 1800				66.945,24
1.2	fume hood 1200				35.402,68
1.3	working table 1800x750x750				36.454,46
1.4	working table 1500x750x750				62.677,26
1.5	moving table 1500x750x900				9.656,70
1.6	metal cabinet by others				0,00
1.7	double workbench 3600x1895x900				15.203,37
1.8	double workbench 3000x1500x900				21.083,84
1.9	double workbench 2500x1200x900				17.194,46
1.10	workbench 750x600x750				764,96
1.11	Chair				8.036,10
1.12	metal cabinet by others				0,00
1.13	Acid/Base Cabinet				6.656,40
1.14	FWF90 cabinet				6.857,25

Për reagjentë dhe kimikateve.						
6	<b>Furnizimi dhe montimi me Kabinet metalik me rrota (lëvizëse)</b> Për ruajtjen e veglave dhe reagjentëve në Laboratorin e Balistikës me shumë fioka/dollapë. (Për restaurimin kimik e NIA). Dimensjonet: 100 x 60 x 120	Copë	3	1000.00	3000.00	Gjermani



12	<b>Furnizimi dhe montimi me kabine për ruajtje të kimikateve për Laboratorët e AKF-së :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Që mbyllet me çelës për të siguruar qasjen e pa autorizuar.</li> <li>Duhet të lidhet me sistemin e nxjerrjes së gazrave dhe ventilimit.</li> <li>Material: Metal i shkallës së lartë (1.0330), i elektro galvanizuar dhe i mbuluar me shtresë polyuretani apo i ngjashëm</li> <li>Dyert: Dy dyer të papërshkueshme nga zëri me</li> </ul>	Copë	8	1500.00	12000.00	Gjermani
----	--	------	---	---------	----------	----------

4

Numri i Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214 / 22 / 102 / 111 -- Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF"

dy shtresa. <ul style="list-style-type: none"> <li>Dorezat e dyerve: Zinku të kompresuar, i lyer me shtresë Kromi apo i ngjashëm.</li> <li>Dimensionet: 120x60x200</li> <li>Raftet të lëvizshme: me kapacitet – 30 kg, vëllim-12 l.</li> <li>Ventilator të integruar për ventilim aktiv.</li> <li>Raftet lëvizëse me mundësi ergonomike për shtyrje/tërheqje apo të ngjashme.</li> </ul>					
--	--	--	--	--	--

#### OE NUK PAJTOHET ME LETREN STANDARDE TE TENDERUESIT TE ELIMINUAR

OE ankues nuk pajtohet me letren standarde të tenderuesit të eliminuar lidhur me arsyetimet e cekura sepse ne baze të Nenit 72 LPP-se dhe Rregullores 001-2022 për Prokurimin Publik, Neni 38 Sqarimi i Tenderëve, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore të kërkojë sqarime shtese apo informata shtese për keto arsye të eliminimit të ofertes tone, pra dispozitat ligjore LEJON apo MUNDESON që kërkojnë sqarimet shtese por këto sqarime kurrsesi nuk lejohet të ndryshojnë KUSHTIN MATERIAL të tenderit, që ne rastin në fjalë nuk do ndryshonin kushtin material përgjigjet tona dhe dokumentet shtese që do t'ju dërgojmë, andaj ne rastin në fjalë do ju bashkangjesim këto dokumente si përgjigje në pajtim me dispozitat e lartë përmendura. Për qdo arsye të eliminimit do ju ofrojmë përgjigje dhe dokument mbështetës nga prodhuesi apo OE që e plotëson kërkesën dhe dëshmin e dosjes së tenderit.

Lidhur me pikën e parë të eliminimit:

1. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet të ofrojë së paku 3 punëtor të certifikuar nga prodhuesi për instalim të digestoreve.

Dëshmi:

OE duhet të ofrojë listën e punëtorëve me certifikatat dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju kemi prezantuar një listë të punëtorëve nga prodhuesi ku shkruan që këta punëtor janë të certifikuar por nuk kemi ofruar fare dëshmi për certifikatat dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe në sqarime të datës 04.11.2022.

**Përgjigje:** Ne ofertë kemi dorëzuar një dokument nga prodhuesi ku figuron lista e 3 punetoreve që janë të certifikuar për instalim të digestoreve. Poashtu ne si OE ankues posedojmë një dokument të titulluar **"Marreveshje"** bashkëpunimi në lidhje me angazhimin e 3 punetoreve të certifikuar për instalim të digestoreve nga prodhuesi Wesemann për këtë aktivitet të prokurimit.



InterLab shpk  
Adresa: Rr. Bardhyl Çausli-Mati 1, Prishtinë  
Email: [interlab.shpk@gmail.com](mailto:interlab.shpk@gmail.com)  
Tel: +37744517811  
NR:601676003

## Agreement

Interlab sh.p.k participating in the tender entitled:

"Supply of forensic equipment and specialized laboratory inventory for ARF"  
No. Procurement: 214-22-10141-1-1-1

presents and certifies that:

The undersigned parties:

1. Interlab sh.p.k with registered office at Bardhyl Çausli-Mati-1 St., Pristina represented by Betim Sadriu
  2. Wesemann International GmbH Sigmanner Weg 31 88239 Wangen im Allgäu
- Sign a agreement for the aforementioned procurement activity, if it to be awarded to Interlab shpk, then Interlab would contract the engineers as follow to perform installation of the article 1 and 2 of the tender dossier.

1. Josef Gutjahr
2. Ronny Fichtmüller
3. Martin Beylen

Interlab SH.P.K.  
Data: Nevzhkrimi-Vula  
  
interlab

**wesemann**  
INTERNATIONAL  
GmbH  
Wesemann International GmbH  
Sigmanner Weg 31  
88239 Wangen im Allgäu  
Tel.: +49 7522 999 81-0  
[info@wesemann-international.com](mailto:info@wesemann-international.com)  
[www.wesemann-international.com](http://www.wesemann-international.com)

Lidhur me kontratat e punes te stafit te certifikuar te prodhuesit Wesemann, kjo është mardhenie kontraktuale e brendshme **"Inter parties"** në mes të prodhuesit Wesemann dhe stafit të tij të certifikuar që bëjnë pjesë në këtë deklaratë. E rendesishme është që në përmbajtje të kësaj deklarate të prodhuesit qartëson se 3 punëtor të tij do bëjnë instalimin e digestoreve që janë të trajnuar dhe të certifikuar direkt nga prodhuesi Wesemann.



### **Lidhur me pikën e dyte te eliminimit:**

2. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor financiar i OE i realizuar në tri vitet e shkuara 2019-2020-2021 kanë qenë jo me pak se 600,000.00 €.

Dëshmi:  
Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës (kopje).

Te kjo kërkesë ju keni dëshmuar qarkullim përmes një deklarate bankare për 3 vitet por që nuk e plotëson kërkesën siç është kërkuar në dosje të tenderit, pasi që ju eliminoni për arsyeje tjera komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar dëshmi bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara nga Administrata Tatimore.

**Përgjigje:** Si OE kemi ofruar një dëshmi nga banka që qarkullimi financiar e tejkalon kërkesën mbi 600,000.00 Euro në 3 Vitet e fundit, andaj në pajtim me Nenin 59.2 dhe 72 të LPP-se, është dashur si AK të kerkoni që të dorëzojmë deklaratat tatimore të dorëzuara në ATK, andaj po ju bashkangjesim deklaratat tatimore në mënyrë që të plotësojmë kërkesën dhe dëshminë e DT.

### **Baza Ligjore**

Në pajtim me dispozitat të Nenit 72 të LPP-se dhe Rregullores 001-2022 për Prokurimin Publik, mundësojnë si në vijim:

Neni 72 të LPP-se

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e kërkuar brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Neni 38 të Rregullores 001-2022 për Prokurimin Publik

38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkojë, ofrohet ose lejohet.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shitesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shitesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shitesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e



*përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe afësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.*

Referuar dispozitave ligjore të lartë cekura, mundësohet të kerkohen dokumente apo informata shtese të OE gjate fazes së vleresimit të ofertave por NUK lejohet të ndryshohet kushti material i tenderit që në rastin të shtatimit të NUK do ndryshonin kushtin material të tenderit.

Autoriteti kontraktues gjate fazes së vleresimit të ofertave në raport me ofertën të bërë shkelje të Nenëve 7, 59, 60, 68, 69 dhe 72 të LPP-së.

Kerkojme nga Autoriteti kontraktues të merre për bazë të gjitha dokumentet e bashkangjitura që janë dëshmi apo prova që e plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit dhe të kualifikoj ofertën të bërë si të përgjegjshme.

#### **PROPOZIM**

**TE APROVOHET**-Kërkesa për rishqyrtim si e bazuar.

**TE ANULOHET**-Njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 09.12.2022

**TË RIVLERESOHET**- Aktiviteti i prokurimit dhe të shpërblehemi me kontratë në pajtim me kërkesat e DT.

Tenderuesit ankues Interlab SH.P.K, si pale e pakënaqur, në pretendimet e tij ankimore kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09/12/2021 në platformën elektronike e-prokurimi me datën 13/12/2022, për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, **KËRKESA PËR SHQYRTIM - i aprovohet pjesërisht BAZUAR.**

Detale dhe argumente për pikat ankimore :

**Përgjigjeje në pretendimin 1 të palës ankimore :** se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar autorizim për pozicionin 15 të përshkrimit të çmimeve, AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim, konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka bërë vlerësimin sipas nenit 59 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë nuk ka shfrytëzuar nenin 72 të LPP për sqarime, andaj në këtë pikë pretendimi është i bazuar.

**Përgjigjeje në pretendimin 2 të palës ankimore:** Se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka autorizim për pozicionet 6 dhe 12 të përshkrimit të çmimeve, AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim, konstaton se OE i rekomanduar të rubrika origjina e produkteve ka vendosur vendin e origjinës Gjermani dhe në të njëjtën kohë ka autorizim prej prodhuesit nga Gjermania andaj komisioni i vlerësimit të ofertave me të drejtë dhe në përputhje të plotë me nenin 59 të LPP-së ka vendosur si të përgjegjshëm OE, andaj në këtë pikë ky pretendim i palës ankimore është i pa bazuar.

**Përgjigjeje në pretendimin 3 të palës ankimore,** lidhur me eliminimin e operatorit ekonomik ankues për stafin e puntorve të kërkuar me dosjen e tenderit, AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim, konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave me të drejtë ka vendosur në eliminimin tuaj për arsye se : Kriteret e parashtruara me dosjen e tenderit janë kritere kualifikuese për pjesëmarrsit në procedurën e caktuar të prokurimit, në këtë rast prezantimi i stafit të prodhuesit pa qenë pjesëmarrës në procedurë dhe



pa pasur marrvëshje të grupit për pjesëmarrje siç parashihet me LPP dhe me nenin " 27. Grup i Operatorëve Ekonomik" të RRUOPP-se, nuk mund të merret parasysh, andaj pretendimi në këtë pikë është i pa bazuar.

**Pergjigjeje në pretendimin 4 të palës ankimore: Lidhur me pretendimin e palës ankimore se AK- nuk ka kërkuar sqarime shtese në bazë të nenit 72 të LPP-se, AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim konstaton se komisioni i vlerësimit letrën standarde kishte dhënë arsyet pse nuk është përdorur neni 72 i LPP "Te kjo kërkesë ju keni dëshmuar qarkullim përmes një deklarate bankare për 3 vitet por që nuk e plotëson kërkesën siç është kërkuar në dosje të tenderit, pasi që ju eliminoi për arsyeje tjera komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar dëshmi bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara nga Administrata Tatimore" megjithatë në këtë pikë pretendimi i palës ankimore është i bazuar.**

#### **Konkluzion:**

- I. **Aprovohet Kërkesa për Rishqyrtim e tenderuesit Interlab SH.P.K, si pjesërisht e BAZUAR, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 09.12.2022 në platformën e e-prokurimit për tenderin "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111 ,.**
- II. **Ministria e Punëve të Brendshme e kthen në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF , me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111.**
- III. **Autoriteti Kontraktues nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.**

#### **➤ Këshille juridike:**

➤

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

#### **Vendimi i dorëzohet:**

1. 1 x 1 Interlab SH.P.K
2. Te gjitha palve të interesuar
3. 1 x 1 e-prokurimit të MPB-ës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

*Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement*

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES<sup>1</sup>**

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF"**

Nr. i prokurimit		214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm		214-22-102-111
Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave €
1	EGO ELSA SH.P.K., Rr.Mehmet Gradica nr.26, Bregu i Diellit, 10000, Prishtine,Kosove	375,735.00
2	Vitech Sh.p.k., Rr. Vicianum nr. 210, 10000, PRISHTINË	379,500.04
3	Flamur Isufi B.L, Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	268,450.00
4	Interlab SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	382,999.81

**Rezultati i aktivitetit të prokurimit:**

Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë tenderuesin: " EGO ELSA SH.P.K", në vlerë totale të ofertës në shumë prej 375,735.00 €.

Data: 27/12/2002

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

<sup>1</sup> Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoni letra njoftuese sipas nevojës).



## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>2</sup>

Prishtinë 27.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Vitech Sh.p.k"

Nr. i prokurimit <sup>3</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm: .

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digestoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtorëve me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju nuk keni prezantuar fare dëshmi listën e punëtorëve siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

<sup>2</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

<sup>3</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

2. Te kërkesa: Artikujt 1 dhe 2 te duhet te jene te certifikuar me standardët EN 14175-1 EN 14175-2 EN 14175-3

Dëshmi:

Kopja e certifikatave te EN Standardeve.

Për këtë kërkesë ju nuk keni prezantuar fare dëshmi siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.( Kopjet e certifikatave te EN Standardeve)

3.Te kërkesa: Operatoret ekonomik, duhet të sjellin katalogët për artikujt 1 dhe 2.

Dëshmi:

Katalogët duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe te jen ne përputhje me kërkesat ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Për këtë kërkesë ju nuk ka prezantuar fare dëshmi (katalogun) me specifikim teknik siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]



## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>4</sup>

Prishtinë: 27.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Flamur Isufi B.I.,"

Nr. i prokurimit <sup>5</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1.Tenderi juaj është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar sepse katalogu i dorëzuar me specifikim teknik nuk i përmbush kërkesën minimale të specifikimeve teknike siç është kërkuar me dosjen e tenderit dhe ne sqarime të datës 04.11.2022 , pasi që ka mos përputhje ndërmjet dimensioneve të kërkuara dhe dimensionet që keni ofruar në katalog: për artikullin 1 është kërkuar që gjatësia të jetë 2700 mm ndërsa është ofruar sipas katalogut 2400 mm dhe për artikullin 2 është e njëjta është kërkuar 2700 mm ndërsa është ofruar sipas katalogut tuaj 2400 mm dhe të pjesa e vëllimi i rrjedhjes së ajrit për artikullin është kërkuar të jetë : 720 m<sup>3</sup>/h dhe artikulli 2 Vëllimi i rrjedhjes së ajrit duhet të jetë 480 m<sup>3</sup>/h për këtë kërkesë në katalogun tuaj nuk ka fare dëshmi lidhur me vëllimin e rrjedhjes së ajrit.

<sup>4</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

<sup>5</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Andaj katalogu nuk i përmbush kërkesat minimale siç janë kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

2. Te kërkesa Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digëstoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtorëve me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë ju keni prezantuar listën e punëtorëve te certifikuar nga prodhuesi por nuk keni prezantuar kontratat ose marrëveshje për dy punëtorët me iniciale, Z. I. dhe G. R. , siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta tij është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_,  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]



## Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>6</sup>

Prishtinë: 27.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

MPB– Departamenti i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: " Interlab " SH.P.K.,"

Nr. i prokurimit <sup>7</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF

I/e nderuar(a) [Z/Znj]/ \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqet 18 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

### ARSYETIM

1. Te kërkesa: Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 3 punëtor te certifikuar nga prodhuesi për instalim te digstoreve.

Dëshmi:

OE duhet te ofroj listën e punëtove me certifikata dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Për këtë kërkesë keni prezantuar një liste te punëtove nga prodhuesi ku thotë qe këta punëtor janë te certifikuar por nuk keni ofruar fare dëshmi për certifikatat dhe kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt, gjithashtu prezantimi i stafit te prodhuesit pa qen pjesëmarrës ne procedurë dhe pa pasur marrëveshje te grupit për pjesëmarrje siç parashihet me LPP dhe me nenin 27 Grup i Operatorëve Ekonomik te RRUOPP-së, andaj kjo kërkesë nuk është plotësuar siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne sqarime te datës 04.11.2022.

<sup>6</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

<sup>7</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

2. AK me date 20.12.2022 përmes letrës Standarde ka kërkuar sqarime dhe dëshmi shtesë, me date 23.12.2022 kemi pranuar një kërkesë nga OE për zgjatje të afatit për sqarime, AK e ka aprovuar kërkesën dhe ka zgjatur afatin deri me date 27.12.2022 ne ora 14:00.

Me date 27.12.2022 AK ka pranuar dëshmitë nga OE përmes platformës së E-prokurimit dëshmi të cilat janë të pjesshme dhe nuk i plotësojnë kërkesat tona.  
Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim furnizimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]



## B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

Prishtinë: 27.12.2022

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

**MPB– Departamenti i Prokurimit**

**Adresa:** Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

**Adresa e tenderuesit: " EGO ELSA SH.P.K "**

Nr. i prokurimit <sup>8</sup>	214-22-10141-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-102-111

**Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF**

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] \_\_\_\_\_

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ne vlerë prej:375,735.00 €*, si përgjigje ndaj *njoftimit të kontratës* për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Më respekt,

\_\_\_\_\_,  
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

\_\_\_\_\_  
[Nënshkrimi]

<sup>8</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

<b>DATË/A:</b>	06.01.2023
<b>REFERENCË:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Interlab SH.P.K.,
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	e-prokurimit
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Agim Islami Zv. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit- MPB
<b>TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtimi për Aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF"

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesë për Rishqyrtimi të Tenderuesi "Interlab SH.P.K., të datës 04/01/2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111,, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 27/12/2022 në platformën elektronike, AK, mbështetur në Ligjit nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

REFUZOHET e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e tenderuesit "Interlab SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 27/12/2022.



Autoriteti Kontraktues – MPB-ja, për këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të hapur, ka publikuar Njoftimin për kontratë, në sistemin elektronik e-prokurimi të KRPP-së me datën 05/10/2022, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte 16/11/2022.

Pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 04/01/2023 kemi pranuar Kërkesë për Rishqyrtim nga tenderuesi "Interlab SH.P.K.:

### **PRETENDIMET ANKIMORE**

Tenderuesi "Interlab SH.P.K.-, si pale e pakënaqur ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK me datën 04/01/2023, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 27/12/2022, për tenderin, "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF ", me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111 , duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068, siç janë:

*Dispozitat e shkelura të Ligjit të Prokurimit Publik sipas Interlab SH.P.K, është si vijon:*

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- Neni 28 Specifikimi teknik
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Rregullorja 001/2022 Neni 38 Sqarimi i tenderëve

#### **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim. Autoriteti kontraktues me datën: 27.12.2022 përmes platformës së E-prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe letrat standarde për të gjithë tenderuesit pjesëmarrës dhe ne njoftim ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatori ekonomik EGO ELSA SH.P.K.*

*Pas publikimit të njoftimit mbi vendimin AK-se ne pajtim me Nenin 10 të LPP-se kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe AK-ja na ka mundësuar qasjen dhe kemi tërhequr të gjithë dokumentet e nevojshme.*

*Për shkak se OE paraprakisht nuk kishte autorizim në oferte nga prodhuesi me seli në Itali, pas procesit të rivlerësimit shihet se AK-ja pas kërkesës për sqarime shtese ky OE ka ofruar autorizimin nga prodhuesi me seli në ITALI që data e autorizimit figuron 02.11.2022, për me shume shif dokumentin :*



## MANUFACTURER'S AUTHORIZATION FORM

To:  
CA: MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS  
Address of CA: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra  
204, Prishtinë, Kosovë  
Contact Person: Fadil Krasniqi  
E-mail: Agron Hoti  
Phone number: 038 200 19 819  
Procurement Number.: 214-22-10141-1-1-1  
Tender Name: "Supply of forensic equipment and specialized laboratory inventory  
for AKF"

RIELLO UPS a well-established manufacturer and supplier of UPS (Uninterruptible Power Supply), having its registered office & factories at Viale Europa 7, 37045 Legnago (VR) Italy and Via Somalia 20, 20032 CORMANO (MI) Italy hereby authorizes; EGO ELSA SH.P.K, with address Mehmet Gradica Nr.26 Bregu i Diellit, 10000 Prishtinë, Kosovë to submit a bid and subsequently, in its own name and on its behalf, negotiate and sign a contract with you, concerning above IFB for the products manufactured by RIELLO UPS.

Sincerely,

Date, Signature and Stamp

2/11/2022

Name, Surname: Roberto Deri  
Position: Regional Manager Europe  
Email: r.deri@riello-ups.com  
Website: www.riello-ups.com  
Tel. Number: +39 02 66327 321

**RPS S.p.A.**  
VIA SOMALIA, 20  
20032 CORMANO (MI)  
C. F. / P. IVA 02647040233



**RPS S.p.A. Riello Power Solutions**  
37045 Legnago (VR) - ITALY - Viale Europa 7 - T +39 0442 655611 - www.riello-ups.com  
CAPITALE SOCIALE € 1230 978 I.v. - R.E.A. VR nr 262286 - Registro Imprese / C.F. / P.IVA 02647040233



Autoriteti kontraktues si dëshmi ka ofruar vetëm autorizimin e prodhuesit me seli ne itali te cilën e ka dorëzuar OE EGO ELSA SH.P.K pas kërkesës për sqarime shtese, por asnjë dëshmi te dokumentuar me prova faktikë dhe bindëse te dokumentuar se dokumentin ne fjale nga prodhuesi me seli ne Itali Riello Ups është dorëzuar te OE EGO ELSA SH.P.K me datën 02.11.2022 apo ndonjë date paraprake. Pra nuk figuron asnjë dëshmi komunikuese te shkruar se dokumenti është para datës se dorëzimit te tenderëve apo me datën 02.11.2022 ne mes prodhuesit Riello ups dhe OE EGO ELSA SHPK siç e kërkojnë dispozitat e Nenit 59 dhe 72 paragrafi 3 te LPP-se.

Për me shume ju lutem referojuni dispozitave qe e rregullojnë kërkesën për sqarime shtese dhe si duhet dokumentuar nga OE apo prodhuesit qe dhe te jene para datës se dorëzimit te tenderëve, sepse nuk duhet te ndryshohet kushti material i tenderit si ne rastin qe p dyshojmë.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Paragrafi 2 Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që



të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Paragrafi 3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Rregullorja 001/2022

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

Paragrafi 2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet

Paragrafi 3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Pretendim ankimor:

Nëse i referohemi dispozitave ligjore në fuqi të LPP-se respektivisht Nenit 72 paragrafi 3 që thotë 'dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive', duhet të ketë dëshmi të shkruar në mes OE EGO ELSA SH.P.K dhe prodhuesit me seli në Itali Riello Ups se operatori ekonomik ka pranuar autorizimin nga prodhuesi me datën 02.11.2022 që bie para datës së dorëzimit të tenderëve në mënyrë që të verifikohet në mënyrë objektive. Pra mungon dëshmia bazike se kur e ka pranuar këtë autorizimin OE i rekomanduar për kontratë dhe për shkak të kësaj mungese dyshojmë se ky autorizim i pranuar nga prodhuesi NUK është para datës së dorëzimit të tenderëve por është pas datës së dorëzimit të tenderëve por në autorizim është vendosur data e tillë "02.11.2022" në mënyrë që të jete në harmoni me kërkesën ligjore të kërkuar nga AK-ja.

Kërkojmë nga autoriteti kontraktues të kërkojë dëshmi shtesë të OE i rekomanduar për kontratë në mënyrë që të arrijmë të verifikojmë në mënyrë objektive dëshmitë dhe provat e prezantuar nga prodhuesi Riello Ups se është pajisur me autorizim para datës së dorëzimit të tenderëve OE EGO ELSA SH.P.K apo me datën 02.11.2022 siç figuron data në autorizim por me dëshmi mbështetëse të verifikueshme në mënyrë objektive.

Autoriteti kontraktues nuk ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore lidhur me artikujt 6 dhe 12 të ofruara nga OE EGO Elsa si produkte të prodhuara nga prodhuesi Wesemann në kërkesën paraprake për rishqyrtim.

Në bazë të sqarimit të marrur nga MPB prej prodhuesit Wesemann International GmbH vërehet se në fakt ju si AK keni kërkuar sqarime në lidhje me produktet 8 dhe 13 për të cilat ky prodhues veqse i ofron. Ndërsa në si OE ju kemi informuar se artikujt 6 dhe 12 nuk ofrohen nga prodhuesi Wesemann International, të cilat OE Ego Elsa i ka ofruar si të prodhuarit Wesemann International në kundërshtim me 99.2 duke tentuar të hedhë në lajthitje AK - MPB.

6/3

Me poshte po ju perslikruajme edhe njehere pretendimet tona ankimore te pashqyrtuara ne kerkesen e pare per rishqyrtim:

Poashtu ne si OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit publik, pasice jemi ne kontakt me prodhuesin e njejt Wesemann te ofruar poashtu nga OE EGO - ELSA si OE i rekomanduar per kontrate, gjate komunikimeve paraprake me prodhuesin ne fjale jemi njoftuar zyrtarisht se per pozicionet nr 6 dhe 12 nuk mund te ofrohen produkte te prodhuara nga ky prodhues. Dhe ne si OE per pozicionet 6 dhe 12 kemi ofruar produkte nga prodhues 4/3 te tjere ne menyre qe te permblushim kerketat teknike duke ofruar edhe Autorizim nga prodhuesi perkates. OE i rekomanduar per kontrate EGO-Elsa nuk e ka plotesuar kerkesen

7/3

teknike sipas DT-se per pozicionin nr. 6 dhe 12 duke u referuar komunikimeve zyrtare me prodhuesin Wesemann dhe keshtu ky OE ka vepruar ne kundërshtim me nenin 99.2 te LPP-se. Te bashkangjitur keni deshmite si oferten zyrtare nga prodhuesi gjerman Wesemann International GmbH.



Angebot		WIAN22035104					15/16
Pos.	Text	Amount	Unit	Price	Total Price		in €
	1 x bottom collecting sump (sheet steel powder-coated)						
	<b>Summe: Laboratory furniture</b>					<b>286.932,72</b>	
	<b>Summary:</b>						
1	<b>Laboratory furniture</b>					<b>286.932,72</b>	
1.1	fume hood 1800					66.945,24	
1.2	fume hood 1200					35.402,68	
1.3	working table 1800x750x750					36.454,46	
1.4	working table 1500x750x750					62.677,26	
1.5	moving table 1500x750x900					9.656,70	
1.6	metal cabinet by others					0,00	
1.7	double workbench 3600x1895x900					15.203,37	
1.8	double workbench 3000x1500x900					21.083,84	
1.9	double workbench 2500x1200x900					17.194,46	
1.10	workbench 750x600x750					764,96	
1.11	Chair					8.036,10	
1.12	metal cabinet by others					0,00	
1.13	Acid/Base Cabinet					6.656,40	
1.14	FWF90 cabinet					6.857,25	



NOMI I PROKURIMIT: 214-22-10141-1-1-1; NIMI I BËNDSHËM: 214 / 22 / 102 / 111 – Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF"						
6	Furnizimi dhe montimi me Kabinet metalik me rrota (lëvizëse) Për ruajtjen e veglave dhe reagjentëve në Laboratorin e Ballistikës me shumë fioka/dollapë. (Për restaurimin kimik e NIA). Dimensionet: 100 x 60 x 120	Copë	3	1000.00	3000.00	Gjermani
12	Furnizimi dhe montimi me kabine për ruajtje të kimikateve për Laboratorët e AKF-së : <ul style="list-style-type: none"> <li>Që mbijet me çelës për të siguruar qasjen e pa autorizuar.</li> <li>Duhet të lidhjet me sistemin e nxjerrjes së gazrave dhe ventilimit.</li> <li>Materiale: Metal i shkallës së lartë (1.0330), i elektro galvanizuar dhe i mbuluar me shtresë poluretani apo i ngjashëm.</li> <li>Dyert: Dy dyer të papërshkueshme nga zëri me</li> </ul>	Copë	8	1500.00	12000.00	Gjermani

-4-

NIMI I PROKURIMIT: 214-22-10141-1-1-1; NIMI I BËNDSHËM: 214 / 22 / 102 / 111 – Titulli: "Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar të specializuar laboratorik për AKF"

dy shtresa.						
Dorëzat e dycerve: Zinku të kompresuar, i lyer me shtresë Kromi apo i ngjashëm.						
Dimensionet: 120x60x200						
Raftet të lëvizshme: me kapacitet – 30 kg. vëllim-12 l.						
Ventilator të integruar për ventilim aktiv.						
Raftet lëvizëse me mundësi ergonomike për shpirtje/lëvizje apo të ngjashme.						

OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson specifikimet teknike të detyrueshme Aneks 1 për artikujt 6 dhe 12, sepse nuk ka mbështetje nga prodhuesi Gjerman sic e ka cekur në ofertën tërë.

#### PROPOZIM

TE APROVOHET- Kërkesa për rishqyrtim si e bazuar.

TE ANULOHET- Njoftimi mbi vendimin AK-se të datës 27.12.2022

TE RIVLERESOHET-Aktiviteti i prokurimit në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe në pajtim me Nenin 72 të LPP-se të kërkohej dëshmi shtesë mbështetëse që dokumentojnë se autorizimi i pranuar nga OE EGO ELSA SH.P.K nga prodhuesi Riello Ups është para datës së dorëzimit të tenderëve 16.11.2022.

#### Detale dhe argumente për pikat ankimore :

##### Pergjigjeje në pretendimin 1 të palës ankimore :

AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim , konstaton se komisioni i rivlerësimit të ofertave në bazë të vendimit për rivlerësim të ofertave dhe në pajtueshmëri me nenin 72 të LPP ka kërkuar sqarime të OE i rekomanduar kontratë.

Sqarimet e dorëzuara plotësojnë kërkesat me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, andaj në këtë pikë pretendimi është i pa bazuar.

**Pergjigjeje në pretendimin 2 të palës ankimore:** Se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka autorizim për pozicionet 6 dhe 12 të përshkrimi i çmimeve, AK- Pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për në këtë pretendim , konstaton se OE i rekomanduar të rubrika origjina e produkteve ka vendosur vendin e origjinës Gjermani dhe në të njëjtën kohë ka autorizim prej prodhuesi nga Gjermania. AK ka pranuar konfirmim pozitiv nga prodhuesi me seli në Gjermani edhe për produktet që OE ankues i konteston pozic. 6,8,12,13, andaj në këtë pikë ky pretendim i palës ankimore është i pa bazuar, andja AK-MPB vepruar në pajtueshmëri me nenin 7,28, 59 dhe 72 të LPP.

### **Konkluzion:**

- I. Refuzohet e pa bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e tenderuesit Interlab SH.P.K, , kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 27.12.2022 në platformën e e-prokurimit për tenderin “Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF”, me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111 ,.
- II. Mbetet në fuqi Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB me 27/12/2022 i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje forenzike dhe inventar te specializuar laboratorik për AKF”, me nr. të Prokurimit: 214-22-10141-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-102-111.
- III. Autoriteti Kontraktues nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

➤ **Këshille juridike:**



Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

### **Vendimi i dorëzohet:**

1. 1 x 1 Interlab SH.P.K
2. Te gjitha palve te interesuar
3. 1 x 1 e-prokurimit të MPB-ës.